

VENDIM Nr. 1
I ASAMBLESË SË JASHTËZAKONSHME
TË AKSIONERËVE



Në Tiranë, sot më dt. 02.12.1999, u bë mbledhja e Asamblesë së Jashtëzakonshme të Shoqërisë Anonime "Furnizim Ndërtim Nr. 2" me pjesëmarrjen e aksionerëve: Shoqëria "ÇOLLAKU" SHPK, përfaqësuar nga ortaku dhe administratori i vetëm Emin Çollaku dhe Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Tiranë, përfaqësuar nga Pranvera Zeneli, me autorizimin Nr. 7786, dt. 01.12.1999 të Ministrit Z. Zef Preçi, për të shqyrtuar disa ndryshime në Statutin e Shoqërisë Anonime "Furnizim Ndërtim Nr. 2" mbas futjes si aksioner të Shoqërisë "ÇOLLAKU" SHPK, që zotëron 51 të aksioneve.

Përfundimisht midis aksionerëve u arrit në marrëveshjen për të bërë ndryshime në Statutin e Shoqërisë Anonime "Furnizim Ndërtim Nr. 2" Durrës si më poshtë :

- **NENI 1** i Statutit:
 - Ndryshohet Emërtimi i Shoqërisë Anonime "Furnizim Ndërtim Nr. 2" në Emërtimin "EUROMAG 2000".
- **NENI 2** i Statutit: Shtohet paragrafi:
 - Magazinim mallrash
 - Transport, parking dhe spedicion intermodal.
- **NENI 2** i Statutit: Shtohet paragrafi si më poshtë:
 - Shteti Shqiptar zotëron 22026 aksione me vlerë nominale 1000 Lekë secili ose 49 % të Kapitali Themeltar.
 - "ÇOLLAKU" SHPK zotëron 22924 aksione me vlerë nominale 1000 Lekë secili ose 51 % të Kapitali Themeltar.
 - Vlerësimi i vlerës së kontributeve të aksionerëve është në zbatim të Kontratës së Shitblerjes të Noterisë Tiranë Nr. Rep. 893, Nr. Kol. 325, datë 19.11.1999 dhe Nr. 3477 Prot. (AKP).
- **NENI 4** shtohet pas fjalës "transferimi" i 49 % të aksioneve do të kryhet me urdhër të Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit sipas legjislacionit në fuqi sipas kësaj rradhe
 - Punonjësve sipas bonove të privatizimit,
 - Pronarëve të truallit dhe aksionerit kryesor.
- **NENI 6** ndryshohet si më poshtë:
Paragrafi i parë mbas fjalës tre anëtarë, shtesa :
 - Dy antarë të Këshillit Mbikqyrës emërohen nga Firma "ÇOLLAKU" SHPK dhe një antar emërohet nga Ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.